

RAPORTIMI I MEDIAVE PËR NGJARET E LUFTËS NË DRENICË  
GJATË VITEVE 1998-1999

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

SHQIPDONA ADEMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË  
PRISHTINË

PRISHTINË  
2021

## **RAPORTIMI I MEDIAVE PËR NGJARET E LUFTËS NË DRENICË GJATE VITEVE**

**1998-1999**

Drenica zë pjesën qendrore të Kosovës, ajo shtrihet me gjatësi 70 km, nga Mali i thatë deri në Carralevë kurse ka një gjersi 50 km nga kurrizi i Qyqavicës deri në Marsor. Lartësitë më të mëdha në zonën e Drenicës janë: Kërrshi i Goleshit 1142m, Carraleva 1200, Qyqavica 1091m, Berisha 1055m, Kozniku 1042m, dhe Goleshi me 1018. Zona e Drenicës përbehet nga dy qytete: Skenderaj dhe Drenasi të cilat janë qendrat kryesore të popullsisë së kësaj zone.

Drenica ishte e njohur ndër shekuj si vend që nuk i nënshtrohej okupatorve të ndryshëm duke filluar nga ai otoman deri tek lufta e fundit 1998-1999, ky vend kishte rritur brez pas brezi burra dhe gra të cilët luftuan për ruajtjen e identitetit shqiptar (Ahmet Delia, Hasan Prishtina, Azem dhe Shota Galica, Shaban Polluzha, Mehmet Gradica, Tahir e Nebih Meha etj). Vitet e 90 ishin një kthese tjetër e madhe në historinë e re të Kosovës, ku represioni dhe dhuna e ushtruar nga okupatori serb ndaj popullsisë shqiptare u bë e pa durushme. Dhunshëm u larguan të gjithë shqiptaret nga puna e tyre, u larguan nxënësit dhe studentët nga ndërtesat e shkollave e fakulteteve. Mund të themi që organizimi i shqiptarve këto vite ishte unik në botë. Shumë familje lëshuan shtëpitë e tyre për nxënësit dhe studentët të cilët ishin dëbuar nga regjimi serb. Gjersa familjet po kujdeseshin që fëmijët dhe studentët të mos humbisnin asnjë ditë mësimi, shumë të rinj tjerë u organizuan që ti dilnin krah atdheut dhe këtyre fëmijëve të ju mundësonin arsimimin pa frikë dhe të lirë.

Gjendja në të cilën ndodhej Kosova, ajo nuk gjendej në agjendën e shtetve ndërkombëtare të cilat po ndjeknin situatën në luftën e Bosnjesë. Duke e parë që situata vetëm po rëndohej në Kosovë, atëherë shqiptarët u organizuan që ta luftoni padrejtsinë dhe pabarazinë që po ushtrohej ndaj popullatës.

Mund të themi se aq sa kishte ndikimi media në ngritjen e propagandës ndaj shqiptarve nga ana e regjimit serb, aq pati edhe në vetëdijësimin e faktorit ndërkombëtar për çështjen e Kosovës. Vrasja dhe masakrimi i shqiptarëve nga ana e policisë serbe u plasuan në agjensitë më të mëdha mediatike si dhe në gazetatat më të njohura botërore. Lufta në Kosovë, ishte e para e cila u transmetua përmes internetit, dhe skenat e tmerrshme nga masakrat u shfaqën në mbarë globin. Zhvillimi i teknologjisë u mundësoi mediave që të transportojnë informatet në shumë agjensi të njohura ndërkombëtare të asaj kohe.

## **Ky punim masteri përmban hyrjen, katër kapituj dhe konkluzionin**

Në hyrje të këtij punimi janë shtjelluar në mënyrë të përgjithshme motivet për zgjedhjen e temës, metodat e studimit, si dhe çfarë rëndësie ka ky punim për literaturën shkencore dhe shoqërinë në përgjithësi.

**Kapitulli I:** *Raportimi imediave për luftërat në ish-Jugosllavi*, trajton, raportimin e mediave për ngjarjet e luftës në Kroacis dhe Bosnies. Në këtë pjesë po ashtu behët një krahasim të raportimit të mediave në këto dy vende me raportimin e mediave dhe propagandën serbe në Kosovë gjatë vitev 1998-1999.

**Kapitulli II:** *Raportimi i mediave në prag të shpërthimit të luftës 1997*, trajton raportimet e mediave për ndërkombëtarizimin e kërkesave të shqiptave të Kosovës për liri dhe barazi. Më tutje trajtohet raportimi i mediave për ngjarjet në Drenicë në prag të shpërthimit të luftës në Drenicë. Se si mediat raportuan për ngjarjet ne prag të shpërthimit të luftës në Drenicë. Si raportuan mediat daljen e UÇK-së dhe ngjarjet e asaj kohe, cfarë ndikimi patën ato në popullatën e drenicës po edhe në gjithë Kosovën. Si e konsideronin politikanet e huaj dhe ndërkombëtar daljen e UÇK-së në publik.

**Kapitullin e III:** *Raportimi i mediave vendore për ngjarjet në Drenicë 1998-1999*, janë trajtuar analizat për mënyrën se si mediat vendore kanë raportuar për ngjarjet në Drenicë 1998-1999, dukë përfshirë masakrat që ndodhën ndaj popullsië civile, dëbimit të popullsië, plaçkitjet, dhunime etj. Në këtë kontekst analiza është zgjeruar edhe në rrafshin e asaj se cfarë ndikimi ka pasur ky lloj raportimi tek popullsia vendëse në Drenicë.

**Kapitulli i IV:** *Raportimi i mediave ndërkombëtare për luftën ne Drenicë*, përmbanë analizë nga raportimi i mediave ndërkombëtare për luftën e zhvilluar në Drenicë gjatë 1998-1999, si e trajtuan ato luftën në këtë zonë dhe se si këto raportime kanë pasur ndikimi në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për luftën në Kosovë.

## **Pyetja hulumtuese:**

- Në çfarë menyre raportuan mediat vendore dhe ato ndërkombëtare gjatë viteve 1998-1999 për luftën në Drenicë?
- Cilat ishin mediat kryesore të cilat i ka shfrytëzuar popullata e Drenicës dhe cili ishte ndikimi i tyre?
- A ka pasur ndikimi media në sensibilizimin e opinionit botëror për ngjarjet e kësaj periudhë?

## **Metodologjia e punimit:**

Me qëllim për të analizuar mënyrën e raportimit të mediave, fillimisht kam bërë një Desk-research të raporteve të shkruara nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me luftën e fundit në Kosovë.

Metodat e Analizës së përmbajtjes është përdore me qëllim që të analizohen dhe krahasohen konceptet dhe diskursi i përdorur në tekste të shkruara të gazetave si: Koha Ditore, Bujku, Zëri dhe të dhe mediat ndërkombëtare Der Spiegel, The Guardian, The Washington Post, BBC. Këto media janë analizuar për raportimet e tyre që i kanë bërë për gjatë viteve 1998-1999.

Po ashtu është përdore edhe metoda e Video-grafisë, janë analizuar fotografitë e luftës, dokumentarët, reportazhet e televizioneve vendore e ndërkombëtare dhe xhirimet e banorve lokalë të cilët ishin pjese e betejave dhe masakrave në Drenicë.